

Nr. Prot.
(Lutemi referoni këtë numër në përgjigje)

Tiranë, më _____.____. 2023

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

Drejtuar: BOE “Optima Communication” sh.p.k., NIPT K71903025A dhe “Pik” sh.p.k., me NIPT L12316016A, adresa: Rruga “Vaso Pasha”, P. 2, Shk. 2 AP 7/1, Tiranë.

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e Hapur – Shërbime – me Mjete elektronike, Marrëveshje Kuadër me një operatorë ekonomik, ku të gjithë kushtet janë të përcaktuara.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: NR-REF- 69433-05-17-2023.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Shërbime në funksion të komunikimit, promovimit dhe organizimit të aktiviteteve të KESH sh.a.”, me fond limit/vlera e pritshme e kontratës: 12,704,540 (dymbëdhjetë milion e shtatëqind e katër mijë e pesëqind e dyzetë) lekë, pa TVSH.

Shumatorja e çmimeve për njësi është: 497,622 (katërqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e njëzetë e dy) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës: 24 (njëzet e katër) muaj.

Publikimet e mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike Nr.45, datë 22/05/2023.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.

Me anë të këtij njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë ofertuesit e mëposhtëm me vlerën përkatëse të ofruara:

1- BOE “Optima Communication” sh.p.k., NIPT K71903025A dhe “Pik” sh.p.k., NIPT L12316016A:

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi është 497,622 (katërqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e njëzetë e dy) lekë pa TVSH dhe vlera e pritshme e kontratave është 10,976,250 (dhjetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë, pa TVSH.

2- Operatori ekonomik “Filara” sh.p.k., NIPT K51611059N, me ofertë ekonomike 0 lekë.

Nga pjesëmarrësit është skualifikuar ofertuesi i mëposhtëm:

Operatori Ekonomik “Filara” sh.p.k., pasi nuk plotëson kriteret e mëposhtme:

- 1- Nuk ka paraqitur formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9.
- 2- Nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës sipas shtojcës 3.

- 3- Nuk plotëson kriterin 2.2.1, pasi nuk ka paraqitur vërtetim për xhiron vjetore të 3 viteve të fundit financiare.
- 4- Nuk plotëson kriterin 2.3.1, pasi nuk ka paraqitur dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 viteve të fundit.
- 5- Nuk plotëson kriterin 2.3.2, pasi nuk ka paraqitur dëshmi që posedon Certifikatën ISO të kërkuar sipas këtij kriteri.
- 6- Nuk plotëson kriterin 2.3.3, pasi nuk ka paraqitur dëshmi se ka në stafin e tij minimalisht 10 (dhjetë) punonjës të siguruar për periudhën (Shkurt 2023 – Prill 2023), nga të cilët të paktën 2 (dy) punonjës të jenë me arsim të lartë në profilin Marketing dhe Artet e aplikuar, Dega Grafike, si dhe të minimalisht një teknik printimi të çertifikuar të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit.
- 7- Nuk plotëson kriterin 2.3.4, pasi nuk ka paraqitur dëshmi se ka në pronësi ose me qera pajisje teknike për të përmbushur kontratën.
- 8- Nuk plotëson kriterin 2.3.5, pasi nuk ka paraqitur profil të kompanisë si dhe metodologjinë dhe strategjinë që ndjek në organizimin e eventeve.
- 9- Nuk plotëson kriterin 2.3.6, pasi nuk ka paraqitur asnjë nga mostrat e kërkuara ditën e hapjes së tenderit.
- 10- Operatori Ekonomik Filara, ka paraqitur listën e çmimeve të shërbimeve sipas shtojcës 2, me vlere zero.
- 11- Ka paraqitur formularin e ofertës, sipas shtojcës 1, me vlerë zero.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë BOE “Optima Communication” sh.p.k., NIPT K71903025A dhe “Pik” sh.p.k., me NIPT L12316016A, adresa: Rruga “Vaso Pasha”, P. 2, Shk. 2 AP 7/1, Tiranë, se oferta e paraqitur, Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi është 497,622 (katërqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e njëzetë e dy) lekë pa TVSH dhe vlera e pritshme e kontratave është 10,976,250 (dhjetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë, pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Totali i pikëve të marra: Nuk është bërë vlerësimi me pikë.

Etj. _____

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23/12/2020, “Për Prokurimin Publik”.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Ergys Verdho